

KAPITULLI KATER

POLITIKA E STREHIMIT DHE DEMOGRAFIA

4.1 HYRJE

Ky kapitull perbehet nga tri pjese. Se pari pershkruan politiken e pergjithshme mbi rritjen e popullsisë per secilin vendbanim. Kjo bazohet ne Planin Konceptual te paraqitur ne Kapitullin 3. Se dyti paraqet dhe analizon te dhenat e popullsisë per vitet 1990, 2001 dhe 2004 duke lejuar parashikime baze te popullsisë (ne 2010, 2015 dhe 2020,) mbi bazen e tendencave te verejtura. Se treti, pershkruajme skenarin e popullsisë, i cili bazohet ne zbatimin e perqasjes se parashikimit te rritjes se popullsisë. Vlen te theksohet se plani nuk supozon qe tendencat e rritjes ne nje komune te caktuar duhen ndertuar ne te njejtin vend ne te ardhmen. Parashikimi se rritja ne fakt mund te ndodhe ne vende te tjera eshte i justifikueshem (d.m.th. ne zonat e rritjes urbane).

4.2 POLITIKA E PERGJITHSHME MBI VENDNDODHJEN E POPULLSISE NE TE ARDHMEN

Objektivi kryesor politik per kete plan eshte grumbullimi i ndertesave dhe aktiviteve urbane ne "vendbanime" (si qytete, qyteza dhe fshatra), te cilat duhen planifikuar ne menyre koherente, te sherbehen dhe te menaxhohen. Kjo do te thote qe (a) nje "vendbanim" duhet ndertuar me nje dendesi te caktuar zhvillimi; (b) kjo dendesi duhet te jete konsistente me infrastrukturen e mundshme per t'u ndertuar; dhe (c) nje vendbanim duhet te kete nje kufi pertej te cilit duhet ndaluar zhvillimi.

Kjo zakonisht nuk ka ndodhur ne Shqiperi dhe jane te nevojshme reforma mjaft te thella ne politika dhe administrim publik. Kete do ta diskutojme me vone, por ne kete faze te hershme te punes ne veme ne dukje vetem qe plani permban propozime per percaktimin e vendbanimeve te ardhshme ne terma te

vendndodhjes, madhesise apo popullsisë dhe lidhjeve (transport dhe infrastrukture.) Vendbanimet kerkojne aftesi ne zbatimin e zhvillimit te planifikuar ne disa vende dhe ne te njejten mase, ne ndalimin e zhvillimit ne vende te tjera. (Nese kjo nuk mund te realizohet, atehere i ashtuquajture "planifikim" eshte natyrisht krejt pa kuptim.)

Paraqitja e politikave ne kete plan ka disa tipare.

- Krijimin e dy qytete relativisht te medha, (Shkodra dhe Lezha), ne te cilat perqendrohet pjesa me e madhe e rritjes se popullsisë.
- Keto qytete rriten nepermjet densifikimit ne qender dhe shtrirjes ne periferi.
- Per me teper, Shkodra do te zgjerohet (kryesisht ne kuptimin nenurban) pergjate nje "korridori" te planifikuar, te cilit i referohemi si "Korridori Shkoder-Koplik".
- Ne vende te tjera plani identifikon disa qyteza shume me te vogla, te cilat bazohen ne vende ekzistuese dhe keto qyteza ne i quajme "Qyteza te Zgjeruara". Keto vende jane perzgjedhur per shkak te "potencialit te tyre per zhvillim". Ato jane Bushati, Shengjini, Velipoja dhe Vau i Dejes. Kemi vleresuar edhe nje rritje te popullsisë per Rezidencat e Pushimeve ne Velipoje dhe Shengjin.
- Vau i Dejes konsiderohet si "porta e hyrjes" ne Kosove ne kufi me malet dhe fushen bregdetare, ndersa Bushati konsiderohet si prerja e rruges Tirane-Lezhe-Shkoder-Podgorice dhe rruges Kosove-Bar (port), (nje "Port Tokesor" potencial ku nderpriten lidhjet per ne Bar dhe Durres).
- Velipoja dhe Shengjini konsiderohen si zona me potencial zhvillimi turistik dhe si zgjatim i rivieres se Ulqinit, pasi te ndertohet nje ure mbi lumin Bune ne rrugen Kosove-Bar.
- Ne rajonin urban, parashikimet per rritjen e popullsisë marrin vetem 10% te tokes bujqesore ne fshatra. Megjithate, detajet e vendbanimeve te tilla nuk jepen ne kete

Plan Rajonal, pasi janë përtej objektivave e games se çështjeve që trajton.

- Kemi propozuar që qytezat e ndryshme në rrethet e Kurbinit, Mirditës dhe Pukës të stabilizohen në kuptimin e numrit të banorëve. Në Kapitullin 3 kemi diskutuar mbi arsye të këtij propozimi (në fakt në besojmë se mundësitë për rritje ekonomike për dhjetëvjeçarin e ardhshëm janë më të ulta se kudo tjetër, kështu që një popullsi e stabilizuar në numër është garancia më e mirë për përmirësimin e cilësive së jetes.)
- Në fundi, popullsia në rritje në "zonat e thella malore" do të ndihmohet të zhvendoset në rajonin urban. Për këto qellime do të vihet në dispozicion toka për zhvillim. Karakteristikat e fshatrave në zonat e thella do të ndryshojnë duke përmirësuar mundësitë e punësimit të banorëve. Disa fshatra me vështirësi në këto aspekt do të lejohen të zhduken.

Në parashikojmë që qyteti i Shkodrës të rritet me rreth 30,000 banorë; qyteti i Lezhës me 60,000; korridori Shkoder me 30,000; Qytezat e Zgjeruara me 20,000, 18,000, 16,000, dhe 4,000; dhe fshatrat e ndryshme të rajonit urban me një total prej 15.000 banorësh.

4.3 ANALIZA E TË DHENAVE MBI POPULLSINË

4.3.1 Përmbledhje

Në vitin 1990 është vlerësuar se popullsia e përgjithshme e rajonit ka qenë 458,000 banorë. Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë me 2001 dha shifrën 415,000 banorë, por besohet se ky është nënvlerësim. Të dhënat e INSTAT-it për vitin 2004 ishin 533,000 banorë, e cila është ndoshta e saktë. Nëse është kështu, rritja e popullsisë gjatë periudhës 1990-04 ishte 118.000 banorë ose 26% në katërmbëdhjetë vjet.

Për vitin 2025, parashikimi ynë i thjeshtë është një rritje në komunat që po peshojnë rritje të popullsisë prej 169,384 banorësh dhe një zbritje prej 47,119

banorësh në ato komunat që po peshojnë ulje të popullsisë. Supozojmë se rritja në rastin e parë shkaktohet nga ulja e popullsisë në rastin e dytë dhe nuk i kemi marrë në konsideratë ato veç e veç por bashkë. Kjo do të çonte në një rritje neto prej 122,265 banorësh brenda 15 vjetësh. Vlerësimi i popullsisë në vitin 2005 ishte 539,000, dhe parashikimi për vitin 2020 është 651,319, me një rritje neto prej 21%.

Kjo është e besueshme, por varet shumë në shpejtësinë dhe madhësinë e zhvillimit të parashikuar të rajonit (në krahasim me atë të Shqipërisë si të tjerë). Këto tema e rimarrim në Kapitullin 8.

4.3.2 Analizat Statistikore

Në Tabelën 4.1 paraqesim të dhënat për popullsinë për secilin komunë për vitet 1990, 2001 dhe 2004, dhe kryejmë veprime të thjeshta mbi to. Megjithatë, besueshmëria e këtyre shifrave baze mund të jetë e diskutueshme (siç vërehet më poshtë) dhe është e nevojshme të procedohet me kujdes kur nxirren përfundime.

Me tej në besojmë se puna mbi demografinë e rajonit (dhe ajo mbi politikën e strehimit) duhet bërë pjesë e një Plani Kombëtar dhe pastaj të ndahen sipas rajoneve. Idealisht kjo punë nuk duhet bërë rajon për rajon dhe pastaj të mblidhet për të dhëna shifrat në nivel kombëtar. Por në nuk kemi mundësi të ndjekim një rrugë të ndryshme nga kjo.

Shtyllat 1 dhe 2: Popullsia sipas Komunave në 1990

Në regjistrimin e vitit 1990 rrethi i Kurbinit ishte i përfshirë në rrethin e Krujës, e cila ishte pjesë e rajonit të Durrësit. Gjithashtu në vitin 1990, Malesia e Madhe ishte pjesë e rrethit të Shkodrës. Ndermjet 1990 dhe 2001 kufinjtë u ndryshuan dhe rrethet Kurbin e Malesi e Madhe dolën me vete.

Në i ndajmë të dhënat e regjistrimit të vitit 1990 për rrethet e përbera në të njëjtat raporte si ato të paraqitura nga të dhënat e vitit 2001, kështu që tani

kemi nje baze per krahasimin e popullsive te dy rretheve.

Ne vleresimin e te dhenave te vitit 1990 per popullsine e komunave perdorem informacionin e INSTAT -it per popullsine e rretheve dhe qyteteve kryesore.

Popullsia e rrethit minus popullsine e qyteteve jep popullsine totale te fshatrave. Kete shifer e ndame ndermjet fshatrave ne raporte te perpjesshme me numrin e banesave dhe keto i mblodhem sipas komunave. Te dhenat mbi banesat i morem nga hartat topografike te shkalles 1:25.000 te pergatitur kryesisht ndermjet 1980 dhe 1990, dhe kemi supozuar qe ka mbetur mjaft konstante deri me 1990.

Shtylla 1 permban totalet e te dhenave te vitit 1990 te INSTAT-it per rrethet, te cilat ne i perdorem per te kryer ndarjen sipas komunave. Ndarjet paraqiten ne Shtyllen 2.

Shtylla 3: *Popullsia Sipas Komunave ne 2001*

Keto te dhena u moren nga regjistrimi i vitit 2001 i botuar nga INSTAT.

Shtylla 4: *Popullsia Sipas Komunave ne 2004 (Dhjetor)*

Keto te dhena konsulentet i moren nga zyrat lokale te INSTAT-it ne Lezhe dhe Shkoder. Verejme se te dhenat per vitin 2004 jane shume me te larta se ato te vitit 2001 dhe besojme se duhet hetuar me tej mbi te dy vitet, para se ato te mund te pranohen.

Shtyllat 5, 6 dhe 7: *Zbritja per te Dhene Rritjen e Popullsise*

Keto shtylla tregojne rritjen e popullsise ne komuna dhe bashki ndermjet viteve 1990 dhe 2001 (Shtylla 5) ndermjet 2001 dhe 2004, (Shtylla 6,) dhe ndermjet 1990 dhe 2004, (Shtylla 7.)

Shtyllat 8 dhe 9: *Llogaritja e Shifrave Absolute per Ndryshimet Vjetore dhe ate 5-Vjeçar ne Komuna dhe Bashki*

Me pas, ne Shtyllen 8 ne ndame ndryshimin 14-vjeçar (Shtylla 7) me numrin 14, per te dhene ndryshimin vjetor linear. Ne Shtyllen 9 e shumezuam kete me pese per te dhene ndryshimin pesevjeçar.

Shtylla 10: *Popullsia per vitin 2005*

Pastaj te dhenave te vitit 2004 (Shtylla 4) i shtuam ndryshimet vjetore (Shtylla 8) per te vleresuar popullsine per 2005.

Shtylla 11: *Parashikimi nga Regjistrimi i 2001 deri me 2005 Duke Perdorur Logjiken e INSTAT-it*

Per te kontrolluar vleresimin e popullsise se vitit 2005 bazuar ne te dhenat e regjistrimit te 2001-it perdorem koeficientet e botuar nga INSTAT-i (per lindjet, vdekjet dhe emigracionin). Eshte e qarte qe shtyllat 10 dhe 11 jane vertet shume te ndryshme (539,053 dhe 456,504, respektivisht.)

Shtylla 12, 13, 14: *Parashikimet per 2010, 2015 dhe 2020 duke Shtuar Popullsise se Vitit 2005 Te Dhenat 5-vjeçare per Rritjen*

Pastaj shtuam (mblodhem) te dhenat per rritjen 5-vjeçare (Shtylla 9) me vleresimin per vitin 2005 per te parashikuar shifrat per vitin 2010 (Shtylla 12,) dhe e perseritem kete veprim per 2015 dhe 2020, (shtyllat 13 dhe 14.)

Duke komentuar mbi te dhenat historike statistikore verejme se ndryshimet ndermjet 2001 dhe 2004 jane çuditërisht te larta. Sipas mendimit te autoriteteve vendore, te dhenat e vitit 2001, kane qene pasaktësisht te ulta. Nese te dhenat e vitit 2004 jane te besueshme, atehere kjo do te krijonte nje shkalle te larte ndryshimi te pavertete ndermjet viteve 2001 dhe 2004. Keshtu si baze per parashikim ne kemi marre ndryshimin (katërmbëdhjetëvjeçar) 1990-2004.

Parashikimin e rritjes apo renies se popullsisë sipas zonave komunare (apo bashkiake) e kemi paraqitur me ngjyra ne hartën e Figures 4.1, dhe aty kemi treguar edhe emrat e tyre bashke me vlerën absolute të popullsisë. Verehet se ka një tendencë të qartë hapësirë.

- Ekziston një brez perëndimor me zona në rritje, të cilat ndodhen përgjatë kufirit me Malin e Zi dhe me vijën bregdetare (por jo Kelmendi).
- Në lindje të saj shtrihet një brez me i gjere me zona në rënie.
- Megjithatë ka dy "anomali": Ekzistenca e një "ishulli" rritjeje në Fushe-Arrez dhe Puke, dhe një korridor i vogël me rënie ku përfshihen Shllaku, Vau i Dejes, Hajmeli dhe Dajçi. Ky ngjan me një hendek ndërmjet dy qytete-rajoneve. Komuna Ana e Malit gjithashtu ka pësuar rënie të njëjare shkalle. Kjo është e papritur dhe të dhenat duhen shqyrtuar perseri.

4.4 SKENARI I POPULLSISË

4.4.1 Rritja dhe Vendndodhja

Në *nuk* kemi supozuar se rritja e parashikuar ndodh gjithmonë në komunat e emëruara prej nesh. Nderimi i parashikimit të popullsisë së një lokaliteti mbi bazën e tendencave historike vetëm të atij lokaliteti mundet të mos jete përfaqëse e sakte. Për shembull, kjo mund të çojë në ndikime negative në mjedis; mund të shpenzojë kot toke me vlerë ekonomike (p.sh. toke bujqësore); mund të jete subjekt i përbytyjeve ose mund të behet e pamundur të sigurohet toke me infrastrukture, e kështu me radhe.

Per pasojë, *mund të jete e nevojshme të mos ndiqet tendenca historike dhe në vend të kësaj të ndiqet një përfaqëse rekomanduese*. Kështu në supozojmë se rritja e parashikuar për disa komuna në fakt ndodh në vende të tjera, duke ndjekur propozimet e ndryshme të treguara në Tabelën 4.2.

Në këto tabelle në emërojmë vendbanimet dhe qytetet (përfshirë korridoret përkatëse nënurbane) dhe këto qytetet e zgjeruara. Në shtyllën e dytë paraqesim shifrat tona për rritjen, të cilat sipas analizës së statistikore lidhen me komunat përkatëse dhe këto tani në i zhvendosim në qytetet, korridoret dhe qytezat (e përmendura në shtyllën e parë). Në shtyllën e tretë jepem shifrat e rritjes së popullsisë. Këto ndahen ndërmjet zonave urbane dhe rurale në një raport 90/10. Elementi rural verehet si potencial për zgjerimin e fshatrave, por nuk jepem detaje të mëtejshme mbi emrat e fshatrave.

4.4.2 Histogramet dhe Paraqitjet e tjera Grafike të Ndryshimeve të Popullsisë

Në Figuren 4.1 paraqiten histogramet e ndryshimit të popullsisë. Zonat me rritje ndodhen mbi vijën zero (dhe zonat me rënie nën këtë vijë). Për secilën zonë tregohen veç e veç popullsia e viteve 1990 dhe 2005 dhe parashikimi për rritjen për vitin 2020. Paraqitje të tjera grafike jepem për vitet 1990, 2005 dhe 2020.

4.5 KONKLUZIONE

Ky ushtrim demografik duhet trajtuar me kujdes. Është e vështirë (ose, në realitet e pamundur) të behet një parashikim duke pritur që të ndodhë me të vertete. Zhvillimi i ngjarjeve varet nga faktorë të pakontrollueshëm, veçanërisht (a) mënyra sesi ecën ekonomia, (sepse popullsia lëviz aty ku ka punë;) dhe (b) nëse objektivat e politikave realizohen me sukses (apo aty afër). Veçanërisht ndryshimet e popullsisë varen nga disponueshmëria e tokës që terheq investitorë, toke e cila mundet ose jo të nxirret në treg gjatë periudhës së kohës në fjalë.

Per këto arsye, planifikuesit nuk flasin me për taktika të llojit "parashiko dhe siguro" por preferojnë taktikën me realiste të "monitorimit dhe rishikimit". Kjo nënkupton përditesimin e përhershëm të të dhenave dhe zbatimin sistematik të një "Procesi të Rishikimit të Politikave". Kjo çështje do të diskutohet më tej në Kapitullin 11 mbi "Implementimin".

ZONA E RITJES	VENDNDODHJET	POPULLSIA E TANISHME 2005	RITJA E POPULLSISE	URBANE	RURALE
Korridori Shkoder	Koplik	13.375	14.549		
	Kastrat	11.951	5.234		
	Postribe	12.383	5.769		
	Rrethinat (50%)	9.669	7.044		
	Gruemire	12.576	722		
	Qender	4.948	1.346		
			64.906	34.644	31.180
Qyteti Shkoder	Shkoder	111.830	26.603		
	Rrethinat (50%)	9.669	7.044	30.283	3.364
		121.499	33.647		
Shkoder Nentotal			68.291	61.463	6.829
Bushat	Bushat	22.646	6.019		
	Berdica	9.536	3.555		
	Gur i Zi	11.873	3.329		
	Barbullush	8.268	5.342		
		52.143	18.250	16.425	1.825
Velipoje	Velipoje	5.813	1.751		
	Dajc	8.875	5.689		
	Holiday residents	14.688	12.000		
			19.440	0	
Vau Dejes	Puke	5.723	3.044		
	Fushe Arrez	5.464	5.520		
	Vig Mnele	3.323	1.242		
	Vau Dejes	5.813	0	4.355	483
		20.323	4.835		
Shengjin	Shengjin	10.791	10.561		
	Holiday Residents		8.000		
			18.561	18.561	0
Qyteti Lezhe	Balldren	10.188	5.342		
	Kolc	6.232	1.791		
	Kallmet	6.710	968		
	Blinisht	5.280	759		
	Shenkoll	13.549	6.516		
	Zejmen	8.601	621		
	Lac	31.362	16.097		
	Milot	19.924	2.028		
	Mamurras	22.037	3.588		
	Fushe Kuqe	7.802	4.377		
	Lezhe	25.149	17.535		
		137,004	60,360	54,329	6,036

Table 4.2 Vendodhja dhe Rritja e Popullise: Skenari per Vitin 2020